

DR. ROLF KÖDDERITZSCH
(8 prill 1941 – 11 gusht 2020)

Më 11 gusht 2020 u nda papritmas nga jeta si pasojë e një infarkti të zemrës Dr. Rolf Ködderitzsch, gjuhëtar gjerman indoeuropianist, i njohur për publikun shqiptar edhe studiues i gjuhës shqipe e si profesor i degës së gjermanistikës në Universitetin e Tiranës. Kishte lindur në qytetin Osterfeld të landit Saksoni-Anhalt më 8 prill 1941. Pas luftës familja e tij u shpërngul në Gjermaninë Perëndimore. Studioi për gjuhësi në Universitetin e Mynsterit (Münster), ku pati si profesorë edhe gjuhëtarët e shquar Ernst Dickermann dhe Karl Horst Schmidt. Në atë Universitet mori gradën shkencore *Magister Artium* (1966) dhe më pas gradën *Doktor* (1968). Profesori i tij Karl Horst Schmidt, përkrahës dhe frymëzues i studiuesve të rinj të zellshëm, e tërhoqi më pas në Universitetin Bohumit (Bochum), dhe më tej në Institutin e Gjuhësisë të Universitetit të Bonnit, ku mori dhe titullin *Këshilltar i lartë akademik* (Akademischer Oberrat). Veprimtaria e tij e mëtejshme shkencore e mësimore u zhvillua në këtë Institut. Fushat kryesore të hulumtimeve të tij që nga studimet universitare janë keltologjia dhe sllavistika. Këtyre iu shtua më pas albanistika, studimi i gjuhës shqipe, të cilën e pati shumë për zemër. Ashtu si te albanologë të tjerë të mëparshëm me gjuhë amtare gjermanishten, edhe te Rolf Ködderitzsch-i studimi i gjuhës shqipe zgjoi pak nga pak një simpati e dashamirësi aktive për popullin dhe vendin e kësaj gjuhe.

Dr. Rolf Ködderitzsch-i erdhi për herë të parë në Shqipëri më 1978. Në atë kohë drejtori i Institutit të Gjuhësisë të Universitetit të Bonnit, Prof. Johann Knobloch (1919–2010) organizonte ekskursione mësimore në vende të ndryshme me punonjës të Institutit. Gjatë një ekskursioni në Ohër u zotua para studentëve të tij se një ditë do t'i çonte në vendin përballë, në Shqipëri. Me këmbënguljen dhe aftësitë e tij diplomatike, duke qenë edhe shtetas i Republikës së Austrisë (kishte lindur në Vjenë), ai ia doli të bindë autoritetet shqiptare të kohës që të praninin për turizëm shkencor një grup studiuesish nga Republika Federale Gjermane, me të cilën aso kohe Shqipëria nuk kishte marrëdhënie diplomatike (u vendosën më 1988). Kështu më 1978 zunë fill “Takimet shkencore gjermane-shqiptare” (Deutsch-Albanische wissenschaftliche Treffen) të organizuara Instituti i Gjuhësisë i Universitetit të Bonit dhe Akademia e Shkencave Shqipërisë me kujdesin dhe mirëkuptimin e veçantë të drejtuesve të tyre Johann Knobloch dhe Aleks Buda, të dy ish-studentë në Universitetin e Vjenës. Studiues gjermanë e shqiptarë mbanin ligjërata nga fushat e tyre të studimeve, rreth të cilave zhvilloheshin diskutime. Pasditeve

për të interesuarit zhvillohej edhe një kurs i përmbledhur i gjuhës shqipe. Si lektor i këtij kursi pata rastin ta njihja atëherë edhe Dr. Rolf Ködderitzsch-in. Në orët e mbetura turistët gjermanë shijonin plazhin dhe detin. Këto takime shkencore e nxitën Dr. R. Ködderitzsch-in të thellohej në studimin e shqipes dhe më pas të zhvillonte edhe një kurs të gjuhës shqipe në Universitetin e Bonnit. Kështu u hap për të një fushë e re studimesh: albanistika. Për vite me radhë ai ishte bashkëpunëtori që përgatiste lëndën e fushës së albanistikës në botimin vjetor prestigjioz *Linguistic Bibliography*, botim i Komitetit të Përhershëm Ndërkombëtar të Gjuhëtarëve (Leiden - Holandë).

Si indoeuropianist Dr. Rolf Ködderitzsch-i ka shkruar një varg artikujsh për çështje të historisë së gjuhës shqipe e të fonetikës historike dhe ka mbështetur lashtësinë e autoktoninë e etnosit shqiptar në trojet e veta. Por atë e ka tërhequr edhe problematika e formimit dhe e zhvillimit të gjuhës letrare shqipe, rrethanat e saj të veçanta në historinë e formimit të gjuhëve letrare të Europës. Ai ka meritën se, duke u mbështetur në teoritë më të reja për gjuhët standarde, dëshmoi se shqipja standarde e sanksionuar në Kongresin e Drejtshkrimit mbështetet mbi parime të drejta dhe përfaqëson një diasistem, që shërben si strehë a kulm mbrojtës (gjer. *Dach*) për variantet e tjera letrare, dialektet dhe gjuhën e përditshme me variacionet e saj vendore, d.m.th. për gjithë diasistemin gjuhësor të shqipes. Gjithashtu u shpreh kundër idesë së rikthimit me vetëdashje të një diglosie letrare të Shqiptarët dhe kundërshtoi pikëpamjen se shqipja e sotme letrare është një instrument diskriminues për atë pjesë të popullsisë, që ka një dialekt amtar të ndryshëm nga baza e standardit. Dr. Rolf Ködderitzsch mori pjesë në konferencën shkencore “Gjuha letrare shqipe dhe epoka jonë” (Tiranë, dhjetor 1984) si edhe në veprimtari të tjera albanologjike në Gjermani, në Shqipëri, në Kosovë e në vende të tjera.

Ashtu si edhe studiues të tjerë, Dr. Rolf Ködderitzsch-i diti të dallonte rrethanat politike të Shqipërisë para viteve '90 nga detyrat e kërkimit shkencor objektiv, duke mbetur një dijetar dashamir e vlerësues për shkencën albanologjike shqiptare dhe për popullin shqiptar. Pas daljes në pension, më 2007, arriti të realizojë një dëshirë të vjetër të shprehur me naivitetin dhe çiltërsinë e tij që më 1982, për të qenë pedagog i gjermanishtes në Universitetin e Tiranës. Prej atij viti dha mësim në degën e Gjermanistikës disa vjet me radhë si docent i ftuar i Fondacionit Johann Gottfried Herder, duke zgjeruar horizontin shkencor të studentëve, po edhe të kolegëve shqiptarë, me dijet dhe përvojën e tij të pasur. Bibliografia e pasur e botimeve të tij nga fusha e studimeve albanologjike dëshmon se sa tërheqëse u bënë për të studimet për gjuhën shqipe dhe aspektet të tjera të historisë së Shqiptarëve.

Bibliografi e botimeve albanologjike të Dr. Rolf Ködderitzsch-it (1985–2010)

- Zu den sprachgeschichtlichen Grundlagen des Albanischen von heute. - *SALb* 22/1985, 2, 109-126.
- Bazat gjuhësore-historike të shqipes së sotme. - në: *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë. Materiale të Konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8 dhjetor 1984*. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1988, 213-229.
- Përshëndetja e Dr. Rolf Këderiçit nga Universiteti i Bonit (RF Gjermane). - në: *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë... f. 560*.
- Gedanken zur Ethnogenese der Albaner aus sprachlicher Sicht. - *BalkE* 31/1988, 3-4, 17-41.
- Keltisch und Albanisch: zwei indogermanische Sprachen im Vergleich. - in: *Deutsche, Kelten und Iren. 150 Jahre deutsche Keltologie. Gearóid Mac Eoin zum 60. Geburtstag gewidmet*. (Tristram, Hildegard L. C. Hsg.). Hamburg, Buske, 1990, 61-70.
- *Aspekte der Albanologie. Akten des Kongresses "Stand und Aufgaben der Albanologie heute", 3-5 Oktober 1988*. Herausgegeben von Walter Breu, Rolf Ködderitzsch und Hans-Jürgen Sasse. Berlin, 1991, 229 f.
- Historische Phonologie des Albanischen: Probleme und Aufgaben. - in *Aspekte der Albanologie...*, 121-130.
- Alb. *grua, grue* 'Frau, Weib; Ehefrau, Gattin'. - in: *Indogermanica et Caucasica, Festschrift für Karl Horst Schmitt*. Berlin/New York 1994, 67-76.
- Albanische Forschungen (speziell ab 1968). - *Kratylos* 39/1994, 1-21.
- Për një gjuhë letrare kombëtare shqipe. - *HiD* 24/1-2, 1996, 1-8.
- Ist die vereinheitlichte albanische Schriftsprache ein Instrument zur Unterdrückung der Gegen? - *Aus der Südosteuropa-Forschung Band 8 Konfliktregion Südosteuropa Vergangenheit und Perspektiven Vorträge der Ringvorlesung an der Rheinischen Friedrich-Wilhelms-Universität Bonn im Wintersemester 1995/1996 und Sommersemester 1996*. Herausgegeben von Wilfried Potthoff. Südosteuropa-Gesellschaft, München, 1997, 61-70.
- Albanisch und Slawisch – Zwei indogermanische sprachen im Vergleich. - *SIGL I*, 1998, 79-88.
- Albanian. - në: Görlach, Manfred (ed.): *English in Europe, Oxford*. Oxford University Press, 2001, f. 291-300.
- Die zwei Albanien - Albanien auf dem Balkan und "Albanien" im Kaukasus: die grossen Sprachfamilien und der Platz des Albanischen. - në: *Albanien Reichtum und Vielfalt alter Kultur*. Herausgegeben vom Staatlichen Museum für Völkerkunde München, 2001, 122-126.
- Ligjëratë për një gjuhë letrare kombëtare shqipe. - në: *Konferenca Shkencore "Gjuha Letrare Kombëtare dhe Bota shqiptare sot" Tiranë, 20-21*

nëntor 1992. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Shtëpia botuese “Shkenca”. Tiranë, 2002, f. 42-49.

- Shqipja dhe trakishtja. - në: *Përmbledhje me studime për Kostandin Kristoforidhin (Materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare “Kostandin Kristoforidhi” – figurë e ndritur e Rilindjes Kombëtare Shqiptare)*. Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan. “Sejko”. Elbasan, 2002, f. 112-122.

- Guillaume Bonnet: Les mots latins de l’albanais. Paris/Montréal, L’Harmattan, 1998, 478 f. – Kratylos, 47 (2002) 195-199 (recension).

- Fonologjia shqipe nga një pikëpamje kontrastive. - në: *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 22/1 (Materialet e punimeve të Seminarit XXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare)*. Prishtinë, gusht 2003). Prishtinë, 2004, 25-34.

- Emërtimet e metaleve në gjuhën shqipe. - në: *Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare. Konferencë shkencore ndërkombëtare me rastin e 95-vjetorit të lindjes së Prof. Eqrem Çabejt. Gjirokastër, më 23 maj 2003*. Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër. Tiranë, 2004, f. 221-232.

- Reflekse të laringaleve indoevropiane në gjuhën shqipe. - *StAlb* 2008, 80-85.

- Albania në literaturën irlandeze të vjetër dhe të mesme. -në: *Eqrem Çabej dhe vendi i tij në shkencat albanologjike. (Konferencë shkencore)*. Në 100-vjetorin e lindjes së Eqrem Çabejt. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Tiranë, 2009, f. 144-147.

- Iuppiter Menzanas: - in: *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*. Herausgegeben von Bardhyl Demiraj. Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2010, f. 326-329.

- Sprache, Literatur und Didaktik. Beiträge des Germanistischen Instituts der Fremdsprachenfakultät der Universität Tirana. - Albanische Universitätsstudien. Rolf Ködderitzsch, Mario de Matteis Hgg. Band 6. Athena-Verlag Oberhausen (Germany), 2010, 104 f.

- Was heißt und zu welchem Zweck studieren albanische Germanisten Anthropologie? - në: *Fachsprache Deutsch (DaF), Interkulturalität und Landeswissenschaft. Albanische Universitätsstudien*. Herausgegeben von Mario de Matteis. Band 3. Athena-Verlag Oberhausen (Germany), 2010, f. 133-143.

Kronika

- Ligjërata të Rolf Këderiçit për probleme të historisë së gjuhës shqipe. - *SFil* 44(27)/1990, 4, 224-225.

- Gjuha standarde mbetet një ideal (Bashkëbisedim me albanologun gjerman Rolf Ködderitzsch). - *Perla* 11/2006, 2, 171-174; *GjJ* 26/2006, 1-4, 210-211.

Shkurtime bibliografike

BalkE = *Balkansko ezikoznanie*. Sofija.

HiD = *Hylli i Dritës* (revistë), Tiranë, 1993-1997; Shkodër, 2006-

Kratylos = Revistë e Indogermanische Gesellschaft (Gjermani)

Perla = Revistë shkencore-kulturore. Fondacioni “Saadi Shirazi”, Tiranë, 1996-2019

SAlb = *Studia albanica*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë, 1964-

SFil = *Studime filologjike*. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë, 1964-

SIGL = *Studia Indogermanica Lodziensia* (Poloni)

StAlb = *Studime albanologjike*. Universiteti i Tiranës - Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 1996-

Emil Lafe

